

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme, të mbajtur më 26.11.2024, në pajtim me nenin 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) dhe (2) dhe neni 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur për Iniciativën e Sasho Ballabanov nga Shtipi, për miratimin e qëndrimit juridik parimor ose mendimit juridik parimor, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Iniciativa e Sasho Ballabanov nga Shtipi, evidentuar nën 03Su.nr.542/24 të datës 23.08.2024, HIDHET POSHTË.

A r s y e t i m

Sasho Ballabanov nga Shtipi parashtrori iniciativë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ku shprehu pakënaqësinë nga procedimi i kryetarit të Gjykatës Themelore Shtip, i cili me aktvendim Su-IZZ.nr.78/22 të datës 31.10.2022, e ka miratuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Shtip për lëndën MALV-P-420/22, të evidentuar për padinë e parashtruesit kundër të paditurës Komunën Shtip – Shtip, për kompensim të dëmit, si dhe për pakënaqësinë nga aktvendimi i marrë i kryetarit të Gjykatës së Apelit Shtip, që me aktvendimin R.nr.42/22 të datës 10.11.2022 e ka caktuar Gjykatën Themelore Radovish si gjykatë reale vendore që të veprojë për lëndën paraprakisht të theksuar MALV-P-420/22. Parashtruesi konsideron se në pjesën e përjashtimit të gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Shtip për nëpunësit e punësuar gjyqësor në të njëjtën gjykatë, çfarë cilësie apo tipari ka parashtruesi i cili është i punësuar si këshilltar gjyqësor, është e nevojshme që të shqyrtohet puna e Gjykatës Themelore Shtip dhe zbatimi i LPK, në mënyrë që iniciativa e tij të trajtohet si propozim në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e njëjta me vetiniciativë të miratojë qëndrim parimor apo mendim juridik parimor për çështje të rëndësishme për sigurimin unik në zbatimin e ligjeve nga gjykatat.

Në përputhje me nenin 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat, Gjykata Supreme e RMV miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore për çështje të rëndësishme për sigurimin unik me zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej tre muajve, dhe jo më shumë se gjashtë muaj me vetiniciativë apo me iniciativë të kryetarit të gjykatës, apo me iniciativë të seancave të gjyqtarëve apo të sektorëve gjyqësorë të gjykatave apo me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut konstatoi se në pajtim me dispozitat e nenit të sipër theksuar 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat, parashtruesi i iniciativës nuk është subjekt i autorizuar për parashtrimin e iniciativës së këtillë, dhe për atë arsye të njëjtën e hodhi poshtë.

**SEANCA E PËRGJITHSHME E GJYKATËS SUPREME
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**